



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1240/1 prot.

Tiranë më 16.05.2024

Lënda: Mendim mbi projektligjin “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”.

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Zyra e Komisionerit”) ka administruar shkresën tuaj nr. 3226/1 prot., datë 10.05.2024, protokolluar me tonën me nr. 1240 prot., datë 10.05.2024, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektligjin “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore” si dhe relacionin shoqërues.

Nga përmbajtja në tërësi e projektligjit, vërejmë disa dispozita të cilat lidhen me procese përpunimi të të dhënave personale, për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson domosdoshmërinë e angazhimit të nismëtarëve të tij për të përmbushur kërkesat dhe detyrimet lidhur me garantimin dhe respektimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, parashikuar edhe në nenin 35 të Kushtetutës.

Në mënyrë që përpunimi të konsiderohet i ligjshëm, duhet të jetë në përputhje me parashikimet e neneve 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), në të cilët janë përcaktuar parimet dhe kriteret ligjore të përpunimit të të dhënave personale.

Lidhur me përmbajtjen e neneve konkrete, sugjerojmë që, në pikën 2, të nenit 17, të projektligjit, pas togfjalëshit “...duke mbrojtur të dhënat personale...” të shtohet togfjalëshi “...në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në vijim të këtij sugjerimi, jemi të mendimit gjithashtu që me ngritjen e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare, (për të cilën Ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë mbart cilësinë e kontrolluesit sipas Ligjit) të parashikohen me një akt nënligjor, dalë në zbatim të këtij projektligji, marrja e masave konkrete teknike dhe organizative të sigurisë për të garantuar standardet më të larta të përpunimit të të dhënave personale bazuar në nenin 27 të Ligjit, sa i takon të dhënave personale të përpunuara në këtë regjistër.

Po ashtu, vlerësohet e nevojshme dhe parashikimi i rregullimeve mbi nivelin dhe monitorimin e aksesit në databazën përkatëse të regjistrit. Monitorimi i aksesit dhe kërkimeve nga autoritetet kompetente është i rëndësishëm, pasi çdo institucion, legjitimohet të aksesojë të dhëna personale, vetëm për atë që lidhet me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së tij.

Së fundmi, edhe caktimi i një afati kohor mbi ruajtjen e të dhënave, përbën një nga kriteret bazë në zbatim të germës d), të nenit 5 të Ligjit, sipas së cilit parashikohet që mbrojtja e të dhënave personale bazohet në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

Me përfshirjen e sa më sipër, projektligji vlerësohet i hartuar konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ndërsa sa i përket pikës 3, të nenit 17 të projektligjit, në të cilën parashikohet se: *“të dhënat e tjera, përveç të dhënave personale dhe atyre që përbëjnë sekret tregtar janë të përdorshme në përputhje me legjislacionin mbi të dhënat e hapura”*, shprehim dakortësinë mbi këtë parashikim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

BESNIK DERVISHI